



Datë:

14.04.2026

A.nr. 308/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.308/2026, të datës 18.03.2026, të parashtruar nga ankuesi R.H, kundër organit të punësimit: Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 14.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.308/2026, e datës 18.03.2026, e parashtruar nga ankuesi R.H.

A r s y e t i m

Ankuesi R.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 18.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, në pajtim me Aktgjykimin KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Lipjanit, ndërsa, kjo e fundit më datë 25.03.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)ndërlidhur me vendimmarrjen administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1390/2026 të datës 18.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 05.03.2026 nga Thesari Pagat; Kërkesën e datës 13.03.2026 e parashtruar nga ankuesi për Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.03.2026; Akt Emërimit e datës 01.08.2024; Pagesën janar, shkurt 2026; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 25.03.2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve është e pabazuar, **sepse**:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit 01 Nr.101/03-37192/2024 të datës 01.08.2024, mban pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i Personelit* në Komunën e Lipjanit.

Tutje ankuesi më datës 13.03.2026, ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e pagës së përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, në pajtim me Aktgjykimin KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore, më datë 16.03.2026, përmes përgjigjes në kërkesë, ka njoftuar ankuesin se Njësia e Burimeve Njerëzore nuk ka kompetencë për ndryshimin e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, pasi që kjo është kompetencë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se paga mbi përvojën e punës përbën element të pagës së fituar dhe duke marr parasysh që e njëjta nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë është zvogëluar në 0.25%, atëherë duke u bazuar në Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e drejta e fituar është njohur dhe përkundër kësaj nuk është zbatuar paga e përvojës së punës 0.5%. Kërkon që të konstatohet se nuk është zbatuar në mënyrë të plotë kompensimi i përvojës së punës dhe të obligoj institucionin përkatës të bëjë kompensimin e shtesës sipas përvojës së punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga koha e hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave në Sektorin Publikë deri në muajin dhjetor 2025.

Lidhur me pretendimin e ankuesit referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të*

kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionin publik që të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas objektit të ankesës së specifikuar më lartë dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk mund të trajtoj në meritë pretendimin ankimor lidhur me kompensimin për përvojën e punës sikurse pretendohet në ankesë, kështu që, pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.308/2026, datë 14/04/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit R.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.